



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 61/1 Prot.

Vlorë më, 09.01. 2025

VENDIM
Nr. 1, datë 09.01.2025

PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT AKADEMIK NË TË GJITHA NIVELET
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 49, pika 1, gërma ç, të Ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" nenit 25 pika 1, gërma ç të Statutit të UV-së, si dhe referuar propozimit të Rektorit të UV-së, ardhur me shkresë Nr.3099, prot, datë, 24.12.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 09.01.2025,

VEREN SE

1. Me vendimin nr.89, datë 20.11.2024 të Senatit Akademik "*Për strukturën organizative të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, është miratuar Struktura organizative e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë në nivel ndihmësakademik dhe administrativ. BA vëren se struktura është organizuar në 10 sektorë. Cdo sektor ka një përgjegjës. Gjithashtu në dispozitiv është përcaktuar se struktura organizative do të jetë pjesë e Statutit të ri të UV-së, sipas nenit 33 të Ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" Po ashtu me vendimin nr 97, datë 17.12.2024 të SA "*Për miratimin e strukturës numerike të përgjithshme dhe Organigramës së UV-së*", i është propozuar Bordit të Administrimit numri i personelit në të gjitha nivelet. Bordi i Administrimit konstatoi se numri i propozuar nga ana e Senatit Akademik ka pësuar një rritje me 5 personel ndihmësakademik dhe administrativ.*

Në vendim përcaktohet qartë se strukturat administrative në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore janë në varësi të Administratorit, ndërsa sektori i auditit është në varësi të Bordit të Administrimit. Kjo hierarki paraqitet edhe në organigramën e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi. Organigrama do të jetë gjithashtu pjesë e Statutit të ri të UV-së, sipas nenit 33 të Ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" si dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 27, datë 29.12.2027, "*Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë*" Në këto kushte Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 09.01.2025,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin e personelit në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, me kusht që rekrutimet e punësimit për personelin e shtuar të bëhen me vendimmarrje paraprake nga ana e Bordit të Administrimit sipas gjendjes financiare.
2. Të miratojë numrin e personelit në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, gjithsej 359 (treqind e pesëdhjetë e nëntë) të shpërndarë si më poshtë:
 - a. Numri i përgjithëm i personelit akademik me kohë të plotë:
236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë)
 - b. Numri i përgjithëm i personelit me kohë të pjesshme:
80 (tetëdhjetë)
 - c. Numri i përgjithëm i personelit të ftuar:
25 (njëzetë e pesë)
 - d. Numri i përgjithëm i personelit ndihmësakademik dhe administrativ:
123 (njëqind e njëzetë e tre)

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Nr. 309 Prot.

Vlorë më, 26.11.2024

Lënda: Mbi propozimin për ndryshimin e strukturës organizative të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

KËTU

Në zbatim të nenin 38, pika 1, gërma ç), nenin 49, pika 1, gërma ç), nenin 57, nenin 66, 67 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet e arsimit të lartë", si dhe raportit të MAS nr.4506/6 prot, datë 25.09.2024 mbi kontrollin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë në zbatim të rekomandimeve dhe gjetjeve të grupit të punës të pasqyruara në Kreun I të këtij raporti, në të cilin evidentohet se në fakultete nuk janë përcaktuar strukturat ndihmës akademike me karakter administrativ, strukturat administrative si dhe të përcaktohen saktë varësia e disa strukturave institucionale, si dhe motivuar nga nevoja për përmirësimin e efikasitetit administrativ, rritjen e cilësisë akademike dhe shërbime ofruar personelit akademik, studentëve dhe të tretëve bashkëlidhur po ju përcjell për diskutim dhe miratim strukturën organizative të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si më poshtë:

1. Numri i personelit me angazhim me kohë të plotë në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, të jetë 358 (treqind e pesëdhjetë e tetë), i shpërndarë si më poshtë:
 - a. Numri i përgjithëm i personelit akademik me kohë të plotë nuk ndryshon:
235 (dyqind e tridhjetë e pesë)
 - b. Numri i përgjithëm i personelit me kohë të pjesshme nuk ndryshon:
80 (tetëdhjetë)
 - c. Numri i përgjithëm i personelit të ftuar nuk ndryshon:
25 (njëzetë e pesë)
 - d. Numri i përgjithëm i personelit ndihmës akademik dhe administrativ propozohet:
123 (njëqind e njëzetë e tre).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI**

2. Hierarkia e strukturës së brendshme të Universitetit 'Ismail Qemali', sipas Udhëzimit Nr. 27, datë 29.12.2027 të MAS, "Për Strukturat e brendshme Akademike dhe Administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", është si më poshtë vijon:
- Strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor dhe ndihmësakademike me karakter administrativ janë në varësi të Rektorit.
 - Bordi Konsultativ, Komisionet e përhershme dhe Këshilli i Etikës janë në varësi funksionale të Kryetarit të Senatit Akademik.
 - Strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor e administrativ, dhe Komisioni i Dhënies së Gradës Shkencore 'Doktor' në nivel njësie kryesore kanë varësi funksionale nga Dekani i njësisë kryesore përkatëse.
 - Strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor, në nivel njësie bazë kanë varësi funksionale nga Drejtuesi i njësisë bazë përkatëse.
 - Strukturat administrative në nivel institucioni janë në varësi të Administratorit të UV.
 - Strukturat administrative në nivel njësie kryesore, në mungesë të Administratorëve të Fakulteteve, mbeten në varësi të Administratorit të Institucionit.
 - Struktura e Auditit të Brendshëm është në varësi të Bordit të Administrimit.

Kjo hierarki organizative paraqitet skematikisht në Organigramën e Universitetit 'Ismail Qemali', sipas materialit bashkangjitur miratuar me vendim të SA nr.97, datë 17.12.2024 "Për miratimin e strukturës numerike të përgjithshme dhe organigramës së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Organigrama e miratuar do të jetë pjesë e Statutit të UV-së sipas sipas nenit 33 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimi,

REKTORI

Prof.Dr. Aurela SALIAJ

